

TË ORIENTOHESH NË BURG



KUJT I DREJTOHET KY UDHËZUES

Ky udhëzues i shkurtër lind nga konstatimi që shumë të burgosur, të cilët hyjnë për herë të parë në burg, dhe shumë persona që, për motive të ndryshme hyjnë në burg, shpesh dinë pak ose aspak mbi organizimin.

I drejtohet pra pikërisht këtyre, në mënyrë që çorientimi që ndeshin të jetë lehtësisht i kapërcyeshëm.

Të dish **kujt**, **si** dhe **kur** të kërkosht diçka lehtëson veprimet dhe përmirëson marrëdhëniet brënda burgut.

Ky botim i parë nuk është perfekt, por është një pikë nisje: do të jenë të mirëpritura sygjerime eventuale për botimet e ardhshme.


*Regione Veneto - ULSS 16 Padova
Dipartimento per le Dipendenze
Unità Funzionale Carcere*

*Osservatorio Regionale
Popolazione Detenuta
e in Esecuzione Penale Esterna*

tel. 049.82.16.931 – 82.16.948

ufcarcere.ulss16@sanita.padova.it – oscar.ulss16@sanita.padova.it

STRUKTURA E BURGUT



Regjistrimi në zyrën e matrikullit

- fotografi
- shenja gishtash
- deklaratë mbi probleme të mundëshme me ndonjë të burgosur tjetër

- vizitë shëndetësore e detyrueshme
- takim me psikologun e të sapoardhurve (Casa Circondariale)

TAKIM I HYRJES SË PARË ME EDUKATOREN

Casellario (magazinë) për tërheqjen e furnizimit të artikujve të nevojës së parë

Casa Circondariale: ndodhen të burgosur personat që janë në pritje të gjyqimit ose që vuajnë dënime nën 5 vjetë.

Casa di Reclusione (o Penale): ndodhen të burgosur personat që kanë marrë një dënim të formës së prerë.

KUR MBËRRIN NË REPART

Për atë që është në paraburgim, nuk bëhen takime me edukatorin që kanë për qëllim vërejtjen e sjelljes.

Por mund të kërkohet një takim për mbështetje morale apo për tu futur në aktivitete.

Vetëm kush ka dënim të formës së prerë bën takime me qëllim vërejtje sjelljeje

Bëhen takime me (edhe me kërkesën e të burgosurit “domandina”)

- Sert. T
- C.S.S.A.
- Vullnetarë
- Operatorë të tjerë

Në hyrje

- regjistrimi, marrje e të gjithë të dhënave të nevojshme për identifikimin (shënja gishtash, gjëndja civile, të dhënat familjare)
- hapje e një dosjeje personale
- depozitimi i gjërave personale në *Casellario* (Casa di Reclusione) ose në Matrikullë (Casa Circondariale)

Çdo të burgosuri i caktohet një numër matrikulli që mbetet i njëjtë për të gjithë kohën e burgimit

Çfarë mund të kërkohet në hyrje

- të lajmërohen familjarët
- të të jepen informacione të përgjithshme mbi procedurat e burgut

Gjatë burgosjes

Një agjent është i pranishëm çdo ditë nëpër reparte, si për çështjet administrative si për ato **juridike**: të emërosh avokatin, të prezantosh apelime apo rekurse, etj.

- prenotimi bëhet duke i dhënë emrin agentit të repartit një natë më parë
- shërbimi është i përditshëm me përjashtim të shtunat, festat dhe parafestat

Në rast urgjence, si skadimi i afateve të paraburgimit, mund të paraqitesh pa prenotim

Nëpërmjet kërkesave të shkruara (domandina) mund të kërkosh dhe dokumentet e mëposhtme

- çertifikatë burgosje (gratis)
- fotokopje të dosjes personale në pjesët e lejuara (me shpenzimet e kërkuarit)
- kopje të pozicionit juridik (me shpenzimet e kërkuarit)

Rregullorja e burgut garanton dhe mundësinë për të hyrë në kontakt me **Magistrato di Sorveglianza** dhe me **Proveditorin Rajonal të Digasterit të Administratës së Burgjeve**.

Mund të kërkohet një takim personal, ose t'i dërgohet atyre kërkesa apo ankesa të shkruara. Për kë nuk disponon materialin e duhur për të shkruar, i furnizohet nga administrata e burgut.



TAKIME, TELEFONATA, POSTË

Mund të bëhen takime me familjarët dhe me persona të tjerë.

Takim me familjarët

Për nënshtetasit italianë që dëshërojnë të takojnë një familjar nuk është e nevojshme asnjë kërkesë. Personi që dëshëron të vijë në takim mund të paraqitet në burg i pajisur me letërnjoftimin dhe një certifikatë që provon shkallën e farefisnisë (gjëndja e familjes ose një certifikatë historike e lëshuar nga Bashkia).

Të huajt mund të takojnë familjarët vetëm kur administrata e burgut ka marrë nga Ambasada një certifikatë që dëshmon shkallën e farefisnisë.

Takime me persona të tjerë (terza persona - person i tretë)

Personi me të cilin do bëhet takimi duhet të prezantoi vetë një kërkesë të motivuar Drejtorit në të cilën të tregoi të gjitha të dhënat e gjëndjes civile dhe adresën.

Takimet janë gjashtë në muaj, një orë secili.

Janë katër në muaj për kë është i akuzuar për një nga krimet e parashikuara në paragrafin 1° të nenit 4 bis të Ordinamento Penitenziario që janë nenet 416 bis i Kodit Penal, 74 dhe 75 i Tekstit Unik Ligjor që dishiplinon lëndët narkotike, 630 i Kodit Penal.

Për raste të veçanta mund të kërkohet të bashkohen orët në një takim të vetëm.

Për kë është në regjim paraburgimi, takimet i autorizon Gjykatësi; ndërsa mbas dënimit i autorizon Drejtori i burgut.

Regullorja e Burgut parashikon që në takim të marrin pjesë maksimumi tre persona

Telefona

Mund të bëhen katër telefonata në muaj për një kohëzgjatje prej dhjetë minutash.*

Kërkesa i paraqitet Drejtorit, me anë të modularëve që gjenden nëpër seksione. Autorizimi për telefonata kërkohet gjithmonë, edhe kur i dënuari vjen nga një burg tjetër në të cilin ishte i autorizuar që të telefononte. Kërkesës mund t'i bashkangjitet fatura telefonike e fundit e personit që i përket telefoni, në këtë mënyrë lehtësohet verifikimi mbi përkatësinë e linjës telefonike.

Mund të thirret vetëm në numra fiks dhe jo celularësh.

Inçizohen telefonatat e të dënuarve për nenet 416 bis (K.P.), 630 (K.P.), 74 (Tekst Unik i Ligjit për drogën) dhe 575 (K.P.), 628 paragrafi i 3° (K.P.), 629 koma e 2° (K.P.), 73 (Teksti Unik i Ligjit për drogën) me rënduesen e nenit 80 koma e 2° dhe për krimet e lidhura me dhunën seksuale.

* Për krimet e parashikuara nga koma 1° e nenit 4bis dhe për krimet e nënshtetësuar bllokimit të përfutimeve ligjore (shiko më sipër, në lidhje me takimet) telefonatat janë dy në muaj.

Posta dhe Pakot

Mund të postohet dhe të merret postë pa asnjë lloj kufizimi, duke shkruar emrin e mbiemrin tek dërguesi.

Mund të merren katër pako në muaj për një total 20 kg, nëpërmjet postës apo takimeve me familjarë. Nëpër seksione gjëndet një listë (model 176 bis) që përmban të gjithë artikujt ose gjërat e lejueshme. Librat, revistat dhe materialet mësimore nuk llogariten në peshën e pakove.

Në zarfin e korrispondencës nuk mund të futen para.



Funksionet që i përkasin marrdhënieve të drejtorisë me të dënuarit ushtrohen nga Drejtori nëpërmjet:

- **Takime me të burgosurit**
- **Mbikqyrje e futjes së të dënuarve në aktivitete trajtuese**
- **Direktiva dhe linja orientuese përgjegjëse të sektorve**

Motivet për të cilat është e mundur t'i drejtohesh Drejtorit

- **Çështje të natyrës juridike të rëndësisë së veçantë**
- **Situata familjare të lidhura me lëshimin e autorizimeve**
- **Situata veçanarisht të rënda ose problematike që i përkasin jetës në institut: në të tilla raste, Drejtori ndërhyr në mënyrë të pavarur dhe sipër palëve, duke vendosur zgjidhjet më oportune në favor të të dënuarit.**

Në ç'mënyrë mund t'i drejtohesh Drejtorit

- **i dënuari mund t'i drejtohet Drejtorit duke i shkruar një letër personale ose nëpërmjet operatorëve**
- **Drejtori mund të presi në audiencë edhe avokatët, familjarët e të dënuarve që bëjnë kërkesë, gjithashtu edhe persona të tjerë**



SEKTORI I SIGURIMIT

Sektori i sigurimit operon në bazë të Ordinamento Penitenziario. Përgjegjësi i Sektorit është Komandanti i repartit, rolit i caktuar aktualisht Komisarëve (Commissari), i cili mbështetet në disa bashkëpunorë. Në institutet me një numër të madh të dënuarish, Komandanti mbështetet nga një Zyrë Sekretarie (Ufficio Comando). Është e pranishme edhe një zyrë mbikqyrjeje me detyra që i përkasin organizimit të jetës në Institut.

Detyrat e Sigurimit në hyrje të Institutit

- shoqërimi në Institut
- kontrolli
- caktimi i qelisë. Bëhet nëpër seksione të ndryshme, Siguria e Lartë, të Mbrojturit, Ordinerët (Alta Sicurezza, Protetti, Comuni) sipas tipologjisë së krimit dhe të dispozicioneve të Autoriteteve Gjyqësore (për shembull izolimi gjyqësorë)

Detyrat e Zyrës së Komandës brënda Institutit

Kjo Zyrë është sekretaria e Komandantit dhe merret me:

- ndarjen dhe administrimin organizativ të punëve dhe të punëtorëve (si për punët fikse, ashtu dhe për punët me radhë)
- vlerësimin e sjelljeve dhe të thyerjeve të rregullores (edhe nëpërmjet komunikimeve të nevojshme Policisë Gjyqësore, të parashikuara nga Kodi Penal, në rastet që paraqesin ekstremet e një krimi)
- urdhëra dorëzimi dhe shërbimi të lidhura me funksionimit të jetës në Institut

Motivet për të cilat është e mundur ti drejtohesh Zyrës së Komandës

- **për caktimin e një aktiviteti pune.**
për të gjithë, mbas gjashtë muajsh nga hyrja në Institut, është e parashikuar një periudhë pune e kohëzgjatjes së një muaji. Ndër kriteret e vendosura për caktimin e një pune të vazhdueshme, (e ashtuquajtur punë fikse) merren parasysh numëri i matrikullit, pozicioni familiar, sjellja dhe njohuritë
- **për të biseduar** mbi probleme eventuale të hasura në Institut dhe që interesojnë në mënyrë të veçantë lejin e telefonatave, bashkëjetesën me të dënuarët e tjerë, vizitat me familjarët.



Organizimi i sigurimit brënda Institutit

Në harkun e 24 orëve nëpër seksione është gjithmonë prezent një agjent.

Në periudhën kohore 8:00-20:00, operojnë edhe agjentë të tjerë

Vartësia e agjentëve është sipas rregullit hierarkik:


- shef i Faktuar
- kordinator i Njësisë Operative
- kordinator i Mbikqyrjes (Nënoficerë inspektor)

Detyrat e Zyrës së Mbikqyrjes

- numërimi i prezencave të të dënuarve, bëhet nga agjentët gjashtë herë në ditë
- kontroll i spostimeve të të dënuarve
- organizimi dhe transferimet e të dënuarve (nëpër Institute, vizita në spital, paraqitje në Gjykatë, urgjenca)
- urgjencat
- organizimi i grupit të shoqërimit në bazë të urgjencës
- ndërrime qelishë
- administrim i personelit të Policisë së Institutit

Agjentëve dhe operatorëve të tjerë të institutit duhet t'i drejtohet gjithmonë duke përdorur "lei"; këto janë të detyruar të përgjigjen në të njëjtën mënyrë dhe të thërrasin të dënuarit në mbiemër. Gjithashtu nuk është e mundur për të dënuarit që të njohi mbiemrin e personelit të Policisë të cilëve duhet t'u drejtohen duke iu riferuar gradave.

POLIZIA PENITENZIARIA (Policia e Burgjeve)





SEKTORI ADMINISTRATIV DHE LLOGARIA

Sektori administrativ dhe i llogarive administrojnë edhe fondet e të dënuarve, duke kuruar hyrjet dhe daljet monetare nëpërmjet një serie operacionesh që kryhen nga Ufficio Conti Correnti (Zyra e Llogarive Rrjedhëse), e cila varet nga Ufficio Cassa (Zyra e Arkës).

Administrimi i parave

Nëse i dënuari që vjen nga liria ka para me vete, këto i dorëzohen Matrikullës që lëshon një riçevutë. Hapet një librezë llogarie e rrjedhshme ku shënohen hyrjet dhe daljet (mod. 73). Çfarëdo shume parash që mbërrin nga jashtë akreditohet mbi këtë librezë. Për kë është në gjysmë-lirie ose për ato që janë në rregjimin e art.21 me punë jashtë Institutit, punëdhënësi dërgon rrogën më anë të bankës. Rroga akreditohet më pas në llogarinë rrjedhëse personale.

Përdorimi i parave

Shuma e parave që mund të disponojë në librezë ç'do person ka një kufi, prej 1000 eurosh për ato që kanë marrë vendim të formës së prerë, ndërsa për kë është në pritje të gjykimit kufiri maksimal është 2000 euro.

- nëse kapërcehen këto shuma, paratë mund të akreditohen në një Librezë depozite në ndonjë Arkë Kursimi të jashtëme
- për kë punon, 1/5 e rrogës akreditohet në një fond të bllokuar nga i cili mund të tërheqësh vetëm në raste të veçanta
- në proporcion me rrogën mbahen kuotat e shpenzimeve
- në fund të vitit konsiderohen interesat ligjore të fondeve të derdhura në llogarinë e secilit

Shpenzimet në para

Të dënuarit mund të blejnë të gjithë artikujt e caktuar nga drejtoria dhe të rradhitura në listën mod.72 e disponueshme nëpër seksione.

Artikujt që dëshirohen të blihen shënohen në një modular; shuma e shpenzuar zbritet nga llogaria e rrjedhshme. Kufiri maksimal për shpenzimet javore është **105,87 euro**, për shpenzimet mujore nuk kalohen **423,48 euro**.

Për blerjen e artikujve që nuk janë të përmbledhura në mod.72, është e nevojshme një kërkesë me shkrim Drejtorit.

Shpenzime të mëtejshme, që mund të lejohen me autorizim janë:

- ndihmë familjes
- shpenzime gjygjësore
- shpenzime shëndetësore (dentisti etj.)

Në momentin e lirimit

Per të huajtë dhe për ato persona që nuk disponojnë të holla, ekziston një kit (i venë në dispozicion nga vullnetarët) që përmban:

- 1 biletë treni
- 4 bileta autobusi
- 1 kartë telefoni;
- 1 bonus prenotimi për 2 netë fjetjeje në hotelin "Albergo a Colori"
- Hartë e Padovës me stacionet e autobusit
- 1 çantë udhëtimi.

Zyra e matrikullit dorëzon kit-in pasi verifikon situatën ekonomike të personit që lërohet, i cili firmos një fletë marrje.



Sektorit Pedagogjik i referohen Servizio Osservazione (Shërbimi i Vëzhgimit), Trattamento (Trajtimi), Konsulencë teknike për Uffici di Sorveglianza (Zyrat e Mbikqyrjes) dhe për plotësimin e kërkesave. Në Casa di Reclusione, sektori pedagogjik trajton edhe masat e semilibertà dhe të Art.21.

Është e koordinuar nga një **Përgjegjës Sektori** dhe përmbledh:

- **edukatorë**
- **edukator përgjegjës sektori**
- **psikologë të Servizio Osservazione e Trattamento**
- **bashkëpunorë sektori**

Aktiviteti i vëzhgimit

Aktiviteti i Vëzhgimit nis me:

- **takim i hyrjes së parë me Edukatorin** (i deleguar nga drejtori)
- **sinjalizim në C.S.S.A.** (Centro di Servizio Sociale Adulti) për ndërhyrje specifike
- **sinjalizim në C.S.S.A.** (Centro di Servizio Sociale Adulti) për ndërhyrje specifike

Në seksion

Për takimet me qëllim vëzhgimi edukatori thërret vetë të dënuarit. Për çdo lloj kërkesë tjetër i dënuari mund të kërkojë me shkrim (domandina) një takim me edukatorin.

Nuk bëhen takime me qëllim vëzhgimi me personat që janë në pritje të dënimit.

Sektori pedagogjik është i koordinuar nga një **Përgjegjës sektori** dhe nga:

- **edukatorët** (përgjegjës sektori)
- **psikologë të Servizio Osservazione e Trattamento**
- **bashkëpunëtorë Sektori**



Çfarë mund t'i kërkohet edukatorëve

- kontakte me asistentë social (për probleme familjare, banese etj.)
- kontakte me asistentë vullnetar
- kontakte me Ser. T e Padovës
- konsulenca në lidhje me kërkesat që mund të paraqiten dhe kujt mund t'i paraqiten
- regjistrime në kurse (shkollore, profesionale)
- informacione mbi aktivitetet e kurseve
- informacione mbi kriteret gjenerale të caktimit të punëve dhe mbi kriteret për formulimin e karakteristikave personale
- kontakte me familjarët, e kufizuar vetëm për situata nevojë dhe me autorizim nga Drejtori
- për të nisur praktikat për: transferime, leje dalje, audienca për zbritjen e ditëve, për masat alternative, për shuarjen e borxheve

Trattamento (Trajtimi)

Përgjegjësit të Sektorit pedagogjik i takojnë:

- funksioni i koordinimit të aktiviteteve trajtuese të brendëshme (shkollë, formacion, punë dhe aktivitete bashkëkrijuese)
- marrëdhëniet me jashtë për nxitje iniciativash formative dhe informative, koordinimin e psikologëve të Servizio Osservazione e Trattamento dhe të asistentëve vullnetarë (artt.17 dhe 78 Ordinamento Penitenziario)

Aktivitete shkollore, formimi dhe bashkëkrijuese

Aktivitete trajtuese të brendëshme përmbledhin kurse shkollore dhe formimi, punë dhe aktivitete bashkëkrijuese.

Rregullorja e burgjeve garanton në çdo institut prezencën e kurseve shkollore të mëposhtëm, të administruara nga shkollat e territorit përkatës: shkollë elementare, gjuhë italiane për të huajt (alfabetizzazione), shkollë fillore. Shkolla e mesme është e parashikuar nga ligji që të jetë në të paktën një Institut burgu për Rreth. Në Institutin e Padovës, është aktiv dhe Seksioni Universitar.

Kurset e formimit profesional dhe aktivitetet e ndryshme bashkrijuese (kulturale, sportive, muzikore) propozohen dhe administrohen nga entë formacioni, shoqata dhe vullnetarë.

Në të gjitha aktivitetet e mësipërme, merret pjesë me anë të kërkesës me shkrim (domandina).



- pavëmendje në pastërtinë dhe rregullin personal apo të dhomës;
- abandonim i pajustificuar i vëndit të paracaktuar;
- moskryerje e qëllimtë e detyrimeve punësore;
- sjellje dhe akte fyese për bashkësinë ;
- lojra dhe aktivitete të palejueshme nga rregullorja e brendëshme;
- shtirje sëmundjeje;
- shkëmbim të mirash mbajtja e të cilave lejohet;
- shkëmbim të mirash mbajtja e të cilave nuk lejohet, apo parash;
- komunikim i palejueshëm me jashtë ose brënda sipas rasteve të përshkruara në numërat 2 dhe 3 të komës 1° të art. 33 të Ordinamento Penitenziario;
- akte të turpshme ose në kundërshtim me etikën publike (burgu, përfshi qelinë, janë vënde publike dhe marrëdhëniet seksuale nuk janë të lejueshme);
- trëmbje apo nënshtrime të shokëve;
- falsifikime të dokumentave të lëshuara nga administrata e Institutit për të dënuarit apo të internuarit;
- përvetësim apo dëmtim të pasurisë së institutit;
- mbajtja apo trafikim i mjeteve të bëra për të dëmtuar personin;
- sjellje ofenduese ndaj operatorëve të burgut ose të personave të tjerë që hyjnë në Institut për arsye pune apo vizite;
- moszbatim urdhrash ose ndalesash ose vonesë e pajustificueshme në zbatimin e tyre;
- vonesë e pajustificueshme kur kthehesh në Institut në rastet e parashikuara nga nenet 30, 30ter, 51, 52, dhe 53 e Rregullores së Burgut;
- pjesëmarrje në çrregullime dhe protesta;
- organizim çrregullimesh dhe protestash;
- arratisje;
- fakte të parashikuara si krime, të kryera ndaj shokëve, operatorëve të burgut, dhe vizituesve.

RAPORTET DISIPLINORE

Nëse një agjent konstaton një mungesë në respektimin e rregullave të radhitura më sipër, shkruan një *Rapporto disciplinare* **Raport disiplinor**, në bazë të të cilin vendosen më pas ndërshtimet.

Kush vendos

Në rast kundërvajtjesh të lehta vendos **Drejtori** i burgut. Kur bëhet fjalë për thyerje të rënda të rregullit mbledhet **Këshilli disiplinor**, i përbërë nga Drejtori, edukatorë dhe mjeku.

Ndërshtimet

- **thirrje** (*richiamo*) është ndëshkimi më i lehtë;
- **qortim** (*ammonizione*);
- **përrashtim nga aktivitetet bashkëkrijuese dhe sportive** deri në 10 ditë (mund të shkohet në vetëm ajrosje apo në shkollë);
- **përrashtim nga qëndrimi në ajrosje**, jo më shumë se 10 ditë;
- **përrashtim nga ç'do aktivitet i përbëshkët** për një maksimum prej 15 ditësh (është sanksioni më i rëndë, parashikon izolimin në një qeli nga ku mund të dilet vetëm për dushin dhe një orë ajrosje, nuk mund të bëhen shpenzime përveçse disa artikujve të nevojës së parë).



Shërbimi i asistencës shëndetësore i drejtohet të gjithë personave të burgosur, nëpërmjet personelit mjekësorë, infermierist dhe qendrave klinike (ku ndodhen).

Garanton:

- vizita mjekësore të përgjithshme
- vizita të specializuara

Si mund të pranohesh në vizita

Për t'u vizituar nga mjeku është e nevojshme të kërkesësh vizitën një natë më parë duke i dhënë mbiemrin agjentit që është me shërbim në seksion.

Shërbimi i mjekut të rojes është aktiv 24 orë përfshi festat.

Për urgjencat mund të informohet agjenti me shërbim në seksion i cili aktivizohet për të lajmëruar mjekun.

Për tu vizituar nga një mjek i jashtëm duhet ti bëhet një kërkesë Drejtorit duke saktësuar motivin (kostoja paguhet nga vetë personi).

Personeli mjekësor	Pranime vizitash
Mjeku i shërbimit	Për një takim është e nevojshme kërkesa me shkrim
Mjeku i Ser. T. (vetëm për përdoruesit e drogës dhe të alkolit)	Vizita e thjeshtë mund të kërkohet një natë më parë
Mjeku i rojes (24 orë në ditë)	Agjenti thërret mjekun në rast nevojë
Specialistë të akredituar	Mund të kërkohet vizita specialiste nëpërmjet mjekut të shërbimit
Psikiatër	
Dentist	
Otorinolaringoiatër	
Infektolog	
Dermatolog	
Okulist	
Orthopedik	
Ekografist	
Kardiolog	
Kirurg	



ÇFARË OFRON SHËRBIMI I ASISTENCËS SHËNDETËSORE



NË MOMENTIN E HYRJES NË BURG

Përpara se të sistemohet në seksion i sapoardhuri vizitohet nga mjeku S.I.A.S., i nënshtrohet analizave të gjakut, dhe, nëse pranon, analizave për prani të lëndëve narkotike në urinë.

NË SEKSION

- në seksion vizitat janë të përditshme (përveç festave) sipas kërkesave të bëra një natë më parë;
- **vizitat e specializuara** bëhen në Infermierinë e Institutit dhe eventualisht në spitale;
- përdoruesve të drogës i soministrohet metadoni në infermeri, në prezencë të personelit mjekësor;
- për sëmundjet infektive si HIV, HCV, e HBV (hepatite), TBC (tuberkulozë) etj. mjeku i caktuar përshkruan analiza periodike kontrolli;
- ilaçet shpërndahen nëpër seksione nga infermierët, sipas përshkrimit të mjekut në:
 - ☐ mëngjes
 - ☐ mesditë
 - ☐ mbrëmje



VARËSI NGA DROGA

Ser. T (Njësi funksionale për burgun) bën pjesë në Dipartimentin për Varësitë të A.S.L. Ser.T garanton:

- certifikimin si përdorues i rregullt droge apo alkooli
- vazhdimësi të kurimit
- predispozim të programeve alternative nga burgu
- ndërhyrje mjeksore, psikologjike dhe sociale gjatë burgosjes

Personeli që operon brënda kësaj njësie është përbërë nga mjekë, infermjerë, psikologë dhe edukatorë.

TRAJTIMI

I burgosuri që sapo ka hyrë në burg, i nënshtrohet:

- vizitë e detyrueshme mjeksore
- vizitë e detyrueshme e psikologut (vetëm në Casa Circondariale)

Nëse i dënuari ka deklaruar të jetë përdorues droge:

- do i nënshtrohet analizave të laboratorit (urinë dhe gjak) për të vërtetuar gjëndjen e deklaruar
- do rregjistrohet në listën e përdoruesve të drogës
- do të ndiqet nga mjeku i Ser.
- takim me psikologun

Nëse i burgosuri është i njohur nga Ser.T

- do të ndiqet nga U.F. Carcere, pasi të ketë prezantuar dokumentacionin e lëshuar nga Ser.T përkatës

Nëse i burgosuri është i njohur nga Shërbimet

- i komunikohet Ser.T të qytetit ku banon për një eventual marrje në ngarkim
- bëhet një vlerësim mjeksorë i gjëndjes së varjes nga droga
- mund të kërkojë nga A.S.L. që t'i bëhen analizat toksikologjike

Nëse analizat toksikologjike janë pozitive

- do filloi nga mjeku i Ser.T një trajtim farmakolog
- nëse është ngaherë nën trajtim mund ta vazhdoi trajtimin farmakolog

Takim me psikologun

- për të vlerësuar gjëndjen aktuale
- për relacionin e vëzhgimit (sintesi)
- për mbështetje morale
- Për mbështetje psikologjike me qëllim riintegrimin social (shiko masat e ndryshme nga burgu)



Çfarë mund t'i kërkohet Ser.T

- të kontaktohet Ser.T që ndiqte më parë personin në liri
- të formulohet një program kurimi i jashtëm në alternativë të kurimit në burg
- të kontaktohen komunitetet e kurimit e/o kooperativat e punës
- të merret ndihmë psikologjike
- të futet në eksperiencë grupesh me qëllim kurimi



Nëse përpara arrestimit i burgosuri ka përdorur pije alkoolike në masa problematike e/o ka qenë nën trajtim nga një shërbim për të alkoolizuarit, në burg mund t'i riferohet Ser. T (U.F. Carcere).

Në momentin e hyrjes do i nënshtrohet

- vizitë e detyrueshme mjeksore
- vizitë e detyrueshme e psikologut për sapoarrestuarit (vetëm në Casa Circondariale)

ëse i dënuari deklaron të jetë përdorues i rregullt alkooli do i nënshtrohet

- vizitë e mjekut të Ser.T
- analiza laboratorit për të vërtetuar gjëndjen e deklaruar (vetëm në Casa Circondariale)
- sinjalizim tek Ser.T përkatës
- marrje në ngarkim nga Ser.T

Edhe nëse e deklaron me vonesë, do i nënshtrohet

- vizitë e mjekut të Ser.T
- nëse i burgosuri njihet nga Ser.T, kjo lëshon një çertifikatë, nëse i bëhet kërkesë
- nëse nuk njihet, do i nënshtrohet një vlerësimi diagnostikues për të vërtetuar gjëndjen e deklaruar të varësisë nga alkooli



Trajtimi në burg për alkoolistët

- mund të kërkohet të merret pjesë në grupe vetëndihme
- ndërpriten pijet alkolike në djetë dhe mund të fillojë trajtimi farmakolog
- është e parashikuar asistenca shëndetësore për monitorimin e patologjive eventualisht të lidhura me përdorimin e alkoolit
- edhe alkoolistët mund të kërkojnë masa alternative të konkorduara me Ser. T

Varësia nga alkooli dhe masat alternative



Si mund të hysh në program?

I kërkohet Ser.T të qytetit të vendbanimit.

Edhe nëse nuk ka një vendbanim, është gjithmonë e mundur t'i drejtohet personelit të Ser.T në burg.



SIEROPOZITIVITETI (HIV) DHE SIDA

Nëse i burgosuri është i infektuar nga kjo sindromë ose dëshiron që ti nënshtrohet një analize për infeksionin e HIV, në burg ruan të drejtën të ketë një asistencë shëndetësore të përshtatshme nëpërmjet:

- analiza laboratorit për të gjithë të sapoardhurit
- analiza periodike monitorimi në prezencë të kushteve të HIV
- vizita kontrolli infektiv
- përshkrim të një terapie farmakologjike të përshtatshme
- mbështetje psikologjike

Gjatë vizitës mjeksore të sapoardhurit pyeten nëse pranojnë t'i nënshtrohen analizave të HIV

**TË GJITHË KANË TË DREJTËN
E REZERVIMIT TË REZULTATEVE**

**ËSHTË GJITHMONË E
KËSHILLUESHME QË
TË NDIQEN TESTET**



- për të ndaluar përhapjen e infeksionit
- për të filluar kurimin sa më parë

Sjelljet që duhen mbajtur

Duhet të kihet parasysh që HIV është një virus që ka pak rezistencë në ambientin e jashtëm dhe që mund të transmetohet nëpërmjet gjakut dhe marrdhënieve seksuale të pambrojtura. Ekzistojnë pak rregulla bazë për t'iu shmangur rreziqeve:

- **evitoni shkëmbimin e sendeve personale** (brisqe rroje, furçe dhëmbësh, etj)
- **evitoni tatuazhet** (janë edhe të ndaluara) pasi përdorimi i gjilpërave të pasterilizuara sjell transmetim sëmundjesh.
- **kujdesuni për higjenën e shërbimeve shëndetësore** (banjo, lavamanë)

Përdorimi i përbashkët i enëve dhe i shërbimeve shëndetësore nuk sjell transmetimin e virusit, megjithatë është gjithmonë e këshillueshme që të respektohen rregullat higjienike.



Lirimi parakohe (*La liberazione anticipata*)

Çdo gjashtë muaj burgosje është e mundur të kërkohet një zbritje dënimi prej 45 ditësh nga dënimi që mbetet për të vuajtur. Është e mundur të marrësh lirim parakohe edhe për periudhën e paraburgimit të kaluar në arrest shtëpie ose për dënimet e vuajtura në “besim të shërbimeve sociale”

Shpërblimi mund të hiqet nëse kryhen krime të tjera përpara mbarimit të vuajtjes së dënimit, edhe në masa alternative nga burgu.

Kushtet për ta marrë

Lirimi parakohe merret kur dënimi ka marrë formën e prerë, dhe duhet të kesh:

- mbajtur sjellje të rregullt
- pjesmarrje në rrugën e riedukimit

Si kërkohet

Kërkesa formulohet në një modular të pranishëm në seksion dhe i drejtohet Gjykatësit të Survejimit, që vendos vetë.

Nuk është e nevojshme asistenca e avokatit.

Puna e jashtme (*neni 21 Ordinamento Penitenziario*) (*Il lavoro esterno*)

Drejtori i burgut mund t'i japi të burgosurit mundësinë të ushtrojë një punë jashtë (nëse sjellja është e shkëlqyer dhe personi i besuar). Puna e jashtëme mund t'i lejohet edhe atyre që janë në pritje të dënimit. Nëse i burgosuri është dënuar për një krim të rëndë (grabitje, gjobvënie, vrasje) mund të marri këtë shpërblim vetëm pasi të ketë vuajtur një të tretën e dënimit.



SHPËRBLIMET LIGJORE

LEJE-DALJET E MERITUARA (*l permessi premio*)

Mund të merren maksimumi 45 ditë leje të merituarua në vit (jo më shumë se 15 ditë me rradhë). Për ti merituar është e rëndësishme opinioni pozitiv i Drejtorit dhe një relacion i ekipit që ta parashikojë në programin e trajtimit (kur bëhet përmblledhja e karakteristikave); për më shumë, dënimi duhet të jetë i formës së prerë.

Kërkesa duhet që ti drejtohet Gjykatësit të Survejimit kompetent për Institutin.

Kushtet për ti marrë

Për të marrë lejet e merituarua, përveç sjelljes së mirë dhe programit trajtues që duhet ti parashikoi, është e nevojshme që dënimi të jetë i formës së prerë dhe që të ekzistojnë këto kushte:

- të kesh vuajtur të paktën një të katërtën e dënimit në rastet e dënimeve të lehta;
- të kesh vuajtur gjysmën e dënimit (sidoqoftë, jo më shumë se dhjetë vjet) në rastet e krimeve të rënda të parashikuara nga koma 2^o e nenit 4bis të Ordinamento Penitenziario (vrasje, grabitje, gjobvënie, trafik droge);
- për dënimet nën 3 vjet, nuk është i parashikuar një periudhë dënimi minimal për tu vuajtur për të marrë leje;
- të dënuarit për krimet e përfshira në paragrafin e parë të nenit 4bis të Ordinamento Penitenziario (terrorizëm, mafia, rrëmbim personi, bandë e organizuar) nuk mund të marrin leje të merituarua, ose vetëm pasi të kenë bashkëpunuar me Drejtësinë, apo nëse nuk ekziston më mundësia materiale për të bashkëpunuar.

Përfundime

Lejet e merituarua mund të revokohen në rastet e mëposhtme:

- atyre që akuzohen ose dënohen për një krim të kryer me dashje gjatë vuajtjes së dënimit, i revokohet për 2 vjet;
- të dënuarve për krime të rënda (grabitje, gjobvënie, vrasje) nëse arratisen ose i revokohen masat alternative, lejet i revokohen për 3 vjet;
- të dënuarve për krime të rënda të cilët akuzohen ose janë dënuar për një krim për të cilin ligji parashikon një dënim ku maksimumi është mbi 3 vjet, kryer gjatë punës së jashtme, një leje të merituar, një mase alternative ose gjatë një arratisjeje, lejet revokohen për 5 vjet.



GJYSMË LIRIE (Semilibertà)

Me këtë masë mund të kalohet një pjesë e ditës jashtë burgut për të ushtruar aktivitete pune që janë të përfshira në programin e trajtimit për të cilin është përgjegjës Drejtori i Institutit.

Rastet në të cilat jepet

- të kesh vuajtur të paktën gjysmën e dënimit ose të paktën 2/3 nëse dënimi është dhënë për një krim të përfshirë në komën 2° të nenit 4bis;
- për dënimet me burg apo arrestim nën gjashtë muaj, nëse personi nuk i është besuar Shërbimeve Sociale;
- të kesh vuajtur të paktën 20 vjet për dënimet e përjetshme;
- të jesh nën një mase sigurimi me burgim (internim në Shtëpi pune) të mos jesh i dënuar për krime të përfshira në komën 1 të nenit 4bis;
- të mos kesh kryer krime gjatë një arratisje, një leje të merituar ose një mase alternative.

Kujt i dërgohet kërkesa

Për dënime ose mbetje dënimi nën tre vjet:

- për kë është në liri, **Prokurorit të Prokurës** që ka vendosur ndërprerjen e dënimit. Prokurori trasmeton kërkesën Gjykatës së Survejimit kompetente;
- për kë është në burg, **Gjykatësit të Survejimit** kompetent në lidhje me vendin e burgosjes.

Për dënimet mbi tre vjet:

kërkesa i dërgohet **Gjykatës së Survejimit**

Ndërhyrje të C.S.S.A. (Qendra të Shërbimit Social për të Rriturit)

Përpara dhënies së kësaj mase, C.S.S.A. i dorëzon Gjykatës së Survejimit ose burgut, nëpërmjet një studimi, të gjithë elementët social dhe familiar të nevojshëm për të formuluar një hipotezë riintegrimi.

Gjatë masës në fjalë, C.S.S.A. i jep asistencë personit mbi territor.



SHPËRBLIMET LIGJORE

BESIMI NË PROVË TE SHËRBIMET SOCIALE (L'affidamento in prova ai Servizi Sociali) (neni.47 Ordinamento Penitenziario)

Me këtë masë i besohet i dënuari mbi territor Shërbimeve sociale për një periudhë të njëjtë me dënimin që i ka ngjelur të vuaj.

Rastet në të cilat jepet

- dënimi ose pjesa e mbetur nuk duhet të kalojë tre vjetët;
 - observimi i personalitetit i kryer në burg nga ekipi i trajtimit.
- Për të burgosurit e infektuar nga SIDA ose nga dobësim i rëndë i imunitetit ose nga sëmundje të tjera të rënda, besimi mund të jepet edhe jashtë kufirit të dënimit të parashikuar më lart. (shiko dhe nenin 47 kuater) faqe 26.

Kufij në dhënien e masës

- krime të kryera me finalitet terrorizmi (neni 575, 628 koma 3°, 629 koma 2° Kodi Penal), përveç rasteve ku është vërtetuar që nuk ekzistojnë më lidhje me krimin e organizuar ose subversive.
 - krime të kryera gjatë një arratisje, një leje, punë e jashtme ose në masë alternative.
- Të dënuarve për krime të veçanta (koma 1° e nenit 4bis Ordinamento Penitenziario) mund t'i besohen Shërbimeve Sociale vetëm nëse bashkëpunojnë me Drejtësinë.

Kujt i dërgohet kërkesa

- **Prokurorit të Prokurës** që ka dhënë ndërprerjen e ekzekutimit të dënimit brenda 30 ditëve nga njoftimi për kë është i lirë. Prokurori transmeton kërkesën Gjykatës së Survejimit të vendit në të cilin ka Zyrën prokurori kompetent i ekzekutimit, që fikson një seancë;
- **Gjykatësit të Survejimit** që ka juridiksion mbi burgun në të cilin ndodhet personi.

Ndërprerja e dënimit për të njëjtën dënim mund të jepet vetëm një herë.



BESIMI NË PROVË PËR RASTE TË VEÇANTA

(L'affidamento in prova in casi particolari)

(neni 94 Tekst unik i ligjeve për narkotikët)

Nëse i burgosuri është një person me probleme të varësisë nga droga ose nga alkooli dhe dëshëron t'i nënshtrohet një programi kurues, mund të kërkojë këtë formë besimi për ta kryer jashtë burgut.

Rastet në të cilat jepet

- dënimi ose pjesa e mbetur duhet të jetë nën 4 vjet
- programi duhet të jetë i konkorduar me operatorët e Shërbimit të përdoruesve të drogës (Ser.T). Shërbimi të cilit i duhet drejtuar, duke i shkruar personalisht ose nëpërmjet operatorëve të Ser. T, është ai i qytetit në të cilin i burgosuri ka pasur vendbanimin e fundit. Kërkesa vlerësohet. Ser. T formulon më pas një program dhe deklaron përshtatshmërinë e personit
- çertifikata që vërteton gjëndjen e varësisë nga droga, është gjithashtu një dokument i nevojshëm për të marrë besimin në provë, dhe jepet nga Ser. T

Kjo masë nuk mund të jepet më tepër se dy herë.

Kujt i drejtohet kërkesa

- **Prokurorit të Prokurës kompetente** (nëse personi ndodhet në liri dhe urdhri i ekzekutimit nuk është dhënë apo zbatuar ende). Prokurori transmeton aktet Gjykatës së Survejimit që fikson seancën;
- **Prokurorit** që ka vendosur ndërprerjen, nëse personi është në liri në ndërprerje të ekzekutimit të dënimit;
- **Gjykatës së Survejimit dhe Prokurorit** që ka dhënë urdhrin e ekzekutimit, nëse personi ndodhet në burg; në ato rasto ku nuk kalohet kufiri i dënimit të parashikuar, urdhërohet lirimi.

Kur nis besimi

Në momenti që nënshkruhet në C.S.S.A. verbali me detyrimet që duhen respektuar.



SHPËRBLIMET LIGJORE

NDËRPRERJE E EKZEKUTIMIT TË DËNIMIT

(Sospensione dell'esecuzione della pena)

(neni 90,91,92,93 Teksti unik i ligjeve që disiplinojnë Drogën)

Ndërprerja e dënimit, për dënimet ose për mbetjet nën 4 vjet, mund të aplikohet në raste e mëposhtme:

- a) persona përdorues të rregullt droge e/o të alkoolizuar për krime që lidhen me statusin e tyre si të tillë;
- b) persona përdorues të rregullt droge e/o të alkoolizuar të dënuar për mbajtje dhe shpërndarje të lëndëve narkotike.

Personat në situata të tilla objektive duhet t'i jenë nënshtruar, apo të jenë në vazhdim e sipër të një programi kurues dhe socialorehabilitues.

Kujt i dërgohet kërkesa

Prokurorit që trasmeton dokumentat Gjykatës së Survejimit e cila vendos brënda 45 ditëve.

Çfarë dokumentash i bashkangjiten kërkesës

çertifikatë që vërteton gjëndjen e varjes nga droga, tipin e programit terapeutik të paracaktuar, saktësi mbi strukturën ku do të zhvillohet programi dhe mbi mënyrën e realizimit.

BURGIM SHTËPIAK (Detenzione domiciliare) (neni 47, koma1ter, Ordinato Penitenziario)

Masa konsiston në ekzekutimin e dënimit në shtëpinë e vetë personit të dënuar, ose në një vënd publik kurimi, asistence ose pritjeje. Aplikohet kur mund të jepet një shtyrje e detyrueshme e ekzekutimit të dënimit (neni 146 Kodi Penal) që intereson rastet e grave shtatzëna o që kanë lindur nga më pak se gjashtë muaj, e personave sieropozitiv, gjëndja e të cilëve nuk i përshtatet burgosjes, personave me gjymtme të rënda fizike, grave që kanë lindur nga më tepër se gjashtë muaj, por nga më pak se një vit, dhe të cilave duhet ti besohet foshnja.

BURGIM SHTËPIAK (Detenzione domiciliare) (neni 656ter, koma 10 Kodi Penal)

Kritere

Dënim jo më të gjatë se tre vjet, edhe pse përbën një mbetje dënimi më të gjatë në rastet e personave në arrest shtëpie.

Kujt i drejtohet kërkesa

- Nëse personi është i burgosur, Gjykatësit të Survejimit i cili vendos të aplikojë Burgimin shtëpiak; derisa nuk është marrë vendimi personi qëndron në arrest shtëpie; Gjykatësi trasmeton dosjen Gjykatës së Survejimit kompetente që fikson seancën;
- Nëse personi është i lirë, Prokurorit të prokurës që ka dhënë ndërprerjen e ekzekutimit të dënimit.

Për personat e sëmurë me SIDA o nga një sëmundje tjetër të rëndë masa mund të jepet edhe jashtë afateve të dënimit të paracaktuara.

Neni 47 quater

Mund t'a marrin personat e prekur nga SIDA konklamata ose nga difiçit i rëndë imuniteti që kanë ose duan të ndërmarrin një program kurimi të përshtatshëm në struktura të caktuara (Njësi operative të sëmundjeve infektive spitalore o tjetër). Ky nen jep mundësinë e aplikimit të masave alternative (besim ose burgim shtëpiak) sepse nuk vendos kufizime në bazë të dënimit të dhënë.

Kërkesa i duhet dërguar Gjykatës së Survejimit, duke i bashkangjitur çertifikatën e Shërbimit Shëndetësor publik osë të burgut.

Ligje dhe norma që interesojna sistemin e burgut

Ligji Gozzini (Legge 663/86)

Ligj ky që në 1986 ka zgjeruar shpërblimet dhe masat alternative të parashikuara nga Reforma e Burgjeve e 1975. Në 1991-92 kanë ndërhyrë masa për luftën kundër krimit të organizuar që më pas, në fakt, kanë shkaktuar një shtrëngim të mundësive për të gëzuar shpërblimet, për një pjesë të madhe të të dënuarve.

Ligji Simeone - Saraceni (Legge 165/98)

E miratuar në 1998, në fund të një rruge të gjatë parlamentare, ky ligj lejon të dënuarit që kanë një dënim apo një mbetje të dënimit nën tre vjet, që të mund të pranohen në besimin në provë të Shërbimit Socialë, pa detyrimin të hynë në burg (nëse kanë disa rekuizite të caktuara si p.sh. një punë, një shtëpi etj.). Kufiri për t'u pranuar, për të dënuarit që janë vartës të drogës, edhe në këtë rast është katër vjet.

Ligji Smuraglia (Legge 193/2000)

Në fuqi nga viti 2000, ky ligj parashikon lehtësime fiskale për ndërmarrjet që punësojnë të burgosurit (si brënda institutit, ashtu dhe në punë të jashtme) dhe ish të burgosurit (në muajt e pas burgut).

Ordinamento Penitenziario; legge 354/75 (Urdhëresa e Burgjeve)

Është ligji i Reformës së Burgjeve, që ka ndërhyrë për të modifikuar një rregullore që ishte në fuqi që më 1931. Fut parimin e riedukimit të të dënuarit, në linjë me nenin 27 të Kushtetutës, dhe vendos masat privuese dhe kufizuese të lirisë.

Regolamento penitenziario (Rregullorja e Burgjeve); D.P.R. 230/2000 (Akt i Presidentit të Republikës)

I futur në Shtator 2000, parashikon disa ndryshime organizuese dhe strukturore për institutet ndërkrimore. Rrjedhoja më konkrete që ka shkaktuar deri sot është heqja i murit që ndante të burgosurit nga të afërmit në dhomën e takimeve.

D.P.R. 309/1990 (Akt i Presidentit të Republikës)

E lëshuar në mbështetje të ligjit 22 Qershor 1990 n° 162, i beson Administratës së Burgjeve detyra të reja në parandalimin dhe kurimin e infeksionit të HIV në mjedisin e burgjeve; trajtim socio-shëndetësor, rihabilitim dhe riintegrim në shoqëri të të burgosurve përdorues droge ose të alkoolizuar.

Testo Unico sull'Immigrazione (Tekst Unik mbi Imigrimin); D.P.R. 286/98

Një tekst ky që reformon të ashtuquajturin Legge Martelli (Ligji Martelli), të mbetur në fuqi nga 1991 deri më 1998. Ky ligj përmban drita dhe hije e, megjithatë, hyrja e tij në fuqi nuk ka prodhuar ndryshime substanciale në numrin e imigrantëve që ndodhen në burgjet italiane, nga disa vite qëndron rreth 30% e të gjithë popullsisë së burgosur, por që në realitete të veçanta si ajo e Casa Circondariale e Padovës, kalon të 90%-at. Kohët e fundit ky ligj është modifikuar nga Ligji 189/2002 (Bossi-Fini), që, midis të tjerash, ka futur dëbimin si masë alternative e burgut për dënimet nën dy vjet.

Kush merret me të burgosurit

Agenti di Polizia Penitenziaria (Agjentët e Policisë së Burgut)

Ruajnë rendin dhe sigurinë nëpër Institute dhe marrin pjesë në aktivitete vëzhgimi dhe riedukimi të të burgosurve.

Educatore (Edukatorët)

Edukatorët marrin pjesë në aktivitete grupi për vëzhgimin shkencorë të personalitetit të të burgosurve. Gjithashtu, merren dhe me trajtimin riedukativ individual ose grupor, duke koordinuar aksionet e tyre me ato të personelit që merret me aktivitetet që i përkasin riedukimit.

Direttore (Drejtori)

Ka përgjegjësinë e administrimit dhe mbarëvajtjes së Institutit. Vendos mbi rregulloren e brëndëshme dhe mund të japi punë të jashtme (nenin 21).

Magistrato di Sorveglianza (Gjykatësi i Survejimit)

Është Gjykatësi që kontrollon zhvillimin korrekt të aktiviteteve të brëndëshme të burgut dhe ato në të ashtëquajturën “sektori penal i jashtëm”. Ka kompetencën të japi leje të nevojshme, leje të merituar dhe ditë të lirimit të parakohshëm (zbritje dënimi për sjellje të mirë).

Tribunale di Sorveglianza (Gjykata e Survejimit)

Është e përbërë nga tre gjykatësa dhe gjithashtu mbështetet në kontributin e ekspertëve (asistentë social, psikologë, ecc.). Vendos mbi dhënjat apo revokimet e masave alternative nga burgu.

Psicologo (Psikologu)

Kryen aktivitetet vëzhgimi dhe trajtimi sipas vlerësimeve të personalitetit dhe të aftësive të rekuperimit të të burgosurit. Gjithashtu merr pjesë në aktivitete organizimi të varjes nga droga. Kryen gjithashtu ndërhyrje të mbështetjes psikologjike.

Unità Funzionale Carcere (Njësi Funkzionale për Burgjet)

Kryen aktivitete kurimi dhe rihabilitimi drejtuar të varurve nga droga. Personeli është i përbërë nga psikologë, mjekë, edukatorë profesionistë.

Medico Ser. T, U.F. Carcere (Mjeku Ser. T)

Garanton shërbimin shëndetësor brënda institutit për të dënuarit që ndiqen nga Ser. T

Insegnanti e operatori della formazione professionale (M°sues dhe operator° t° formimit profesional)

Ofrojnë stimuj për përvetësimin dhe përmirësimin e rekuiziteve të nevojshme për riintegrimin shoqërorë.

Cappellano e altri ministri di culto (Prifti dhe të dërguar të tjerë besimi)

Garantojnë asistencë fetare, dhe mbështetje morale.

Volontari (Vullnetarë)

Ofrojnë mbështetje për të përballuar vështirësitë që lindin nga dënimi dhe marrin pjesë në organizimin e nismativave të karakterit kultural, sportiv dhe bashkëkrijues.

Asistenza Sociale

Centro di Servizio Sociale per Adulti C.S.S.A. (Qendra Shërbimesh Sociale për të Rritur)

Janë aktiv pranë çdo Gjykate Penale dhe kujdesen për mbledhjen e informacioneve mbi familjet e të burgosurve, në afërm të lejeve ose të pranimit në masa alternative. Një përfaqësues i CSSA bën pjesë në Ekipin që përpilon sintezën e sjelljes që i duhet çdo të burgosuri për të marrë shpërblimet ligjore dhe masat alternative. Kohët e fundit është ndryshuar emri i C.S.S.A. në “Ufficio per l'Esecuzione Penale Esterna” (Zyra e ekzekutimit penal të jashtëm).

Consigli di aiuto sociale (Këshille t° Ndihm°s Sociale)

Duhet të jenë të pranishëm pranë çdo Gjykate penale dhe të drejtohen nga Presidenti i së njëjtës Gjykate. Duhet të ndjekin vazhdimësinë e riintegritit e të dënuarve që ndodhen na masa alternative.

Servizi Tossicodipendenze (Shërbime për të Varurit nga Droga)

Të vendosura nga DPR 309/90 (Akt i Presidentit të Republikës), ndodhen në çdo qendër shëndetësore A.S.L. dhe na ambulatorë të tjerë nëpër territor, për t'u dhënë asistencë mjeksore dhe psikologjike përdoruesve të drogës.

“4 bis”

Neni 4 bis i Urdhërores së Burgjeve, i futur na 1991, i vështirëson marrjen e shpërblimeve dhe të masave alternative nga burgu, të parashikuara nga ligji, të dënuarve për krime të rënda (grabitje, estorsion, vrasje, trafik droge) dhe ia ndalon krejtësisht të dënuarve për krime të organizuar (rrëmbim personi, organizim me qëllim trafik droge, mafia).

Fjalë të tjera të lidhura

“41 bis”

Neni 41 bis i Urdhëresës së Burgjeve. Regjim ndërprerje të rregullave të trajtimit të parashikuara nga Urdhërorja e burgjeve. I njohur edhe si “burg i rreptë”. I futur në 1992 për t'i bërë ballë krimit mafioz, ishte parashikuar që të qëndronte në fuqi deri në 1995. Në '95, një ligj e zgjati deri në 1999; në '99 është zgjatur sërisht deri në 2003, vit në të cilin u bë i përhershëm. Mund t'u aplikohet të gjithë të dënuarve për krimet e përmbledhura nga neni 4 bis, nëse ekzistojnë motive sigurimi që e kërkojnë.

“416 bis”

Neni 416 bis i Kodit Penal, parashikon dhe dënon krimin e organizimit të llojit mafioz. Bëhet fjalë për një krim që përjashtohet nga gëzimi i të gjitha shpërblimeve ligjore dhe masave alternative nga burgu, përveçse në ato raste ku i dënuari bashkëpunon me drejtësinë apo bashkëpunimi është i pamundur sepse të gjitha faktet janë të qarta.

Area penale esterna (Zona penale e jashtme)

Përfshin të gjithë të dënuarit që ndodhen në masa alternative nga burgu, në punë të jashtme dhe shpërblime të tjera jashtë-mureve, që janë gjithmonë mënyra për vuajtjen e dënimit.

Attività extramurale (Aktivitete jashtë-mureve)

Janë ato aktivitete që të dënuarit mund të kryejnë jashtë burgut: leje të merituar, punë e jashtme, gjysmëlirë, etj.

Attività di osservazione e trattamento (Aktivitete vëzhgimi dhe trajtimi)

Janë në kompetencën e sektorit pedagogjik dhe përmbajnë aktivitetet që i shërbejnë riedukimit dhe rihabilitimit të të burgosurve; shif edhe “sintesi”.

Essere nei termini (Të jeshë në afatet)

Do të thotë të keshë vuajtur një pjesë të mjaftueshme të dënimit për të pasur mundësinë që të marrësh shpërblimet ligjore dhe masat alternative nga burgu.

Misure alternative (Masat alternative)

Masat alternative nga burgu, të futura nga Riforma e Burgjeve e 1975 dhe nga ligje të tjera të mëpasshme, janë: gjysmëliria, besimi në prove të shërbimit social, burgosje shtëpie.

Sintesi (Karakteristika)

Është një relacion i shkruar që përmbledh, të dhëna mbi sjelljen e mbajtur nga i burgosuri gjatë vuajtjes së dënimit dhe një hipotezë mbi atë që mund të jetë vazhdimi i rrugës së riedukimit (eventualisht edhe në masë alternative). Shkruhet nga një ekip që përfshin edukatorë, psikologë, agjentë të policisë së burgjeve dhe asistent social.

Administrative (zona, kontabël): faqe 10
Afatet (të jesh): faqe 29
Agjentë të policisë së burgut: faqet 9, 13
Aktivitetet bashkëkrjuese dhe sportive: faqe 12
Aktivitetet brënda mureve / jashtë mureve: faqe 29
Aktivitetet trajtuese: faqet 11, 12, 28
Alkool - alkoolizuar: faqet 14, 15, 18, 19, 25, 26
Alternave masat: faqet nga 23 a 27, 29
Analiza Hcv/Hiv: faqet 14,19,20
Analizë diagnostikimi: faqe 18
Ankesat: faqe 7
Asistenca shëndetësore: faqet nga 14 te 20
Asistenca sociale: faqet 12, 23, 24, 28
Asistentë (gradat): faqe 9
Asistentë Social: faqet 12, 28
Asistentë vullnetarë: faqet 4, 28
Bashkëpunorë zone: faqe 11
Besimi: faqet 19, 24, 25, 27, 28
Borxhet (falja e): faqe 12
Bossi-Fini (legge): faqe 27
Brigadier: faqe 9
Burgje (policia e): faqet 9, 13
Burgje (Urdhërore): faqet 8, 12, 13, nga 22 ke 24, 27, 29
Burgosje (çertifikata e): faqe 5
Burgosje shtëpie: faqe 26
C.S.S.A.: faqet 4, 11, nga 23 te 25, 28
Çertifikatë burgu: faqe 5
Dentisti: faqet 10, 14
Diagnostikimi (analiza): faqe 18
Dipartimenti për varësitë nga droga dhe alkooli: faqe 16
Disiplina (këshilli i): faqet 13
Disiplinor (raport): faqe 13
Dosja: faqe 5
Drejtori shëndetësor: faqet 10, 13
Drejtori: faqet 6, 7, nga 12 ke 14, nga 21 ke 23, 28
Droga: faqet 16,17
Edukatori: faqet 4, 11, 13, 27, 28
Ekipi: faqet 22, 29

Ekspulsioni: faqe 27
Falja e borxheve: faqe 12
Familjarët (takimet me): faqe 6
Femrat: faqe 26
Fondi i bllokuar: faqe 10
Fondi i të burgosurve: faqe 10
Formacion: faqet 12, 28
Gjykatësi i Mbikqyrjes: faqet 6, nga 21 ke 24, 26, 28
Gjysmëllirë, gjysmë të lirët: faqet 23, 29
Gozzini (legge): faqe 27
HCV: faqe 15
HIV: faqet 15, 20
Ilaçet: faqe 15
Infektivologu: faqet 14, 20
Infermieri: faqe 15
Inspektori: faqe 9
Izolimi: faqet 8, 13
Kërkesa (domandina): faqet 4, 5, 11, 12
Kërkesat: faqet 5, 6, 11, 12, 23, 24, 26
Këshille të ndihmës shoqërore: faqe 28
Këshilli disiplinor: faqe 13
Komandanti: faqet 8, 13
Konsulencë teknike: faqe 11
Kontabël (sektori administrativ): faqe 10
Korrespondenca: faqe 6
Kurimi (metadoni / psikofarmakologjik): faqet 15, 17, 20
Kurimi (programi): faqet 17, 19, 25, 26
Kurse (shkollore dhe formacioni): faqe 12
Lejet e merituar: faqet 8, 22, 28
Ligjet: faqe 27
Lirimet: faqe 10
Lirimi parakohe: faqe 21
Lista e çmimeve: faqe 10
Llogari e rrjedhshme (zyra): faqe 10
Llogari e rrjedhshme: faqe 10
Magazina: faqet 4, 5
Magazina: faqet 4, 5
Masat alternative: faqet nga 23 ke 27, 29
Matrikulli: faqet 4, 5, 10
Mbikqyrja (Gjykatësi-Gjykata): faqet 5, 6, nga 21 ke 26, 28
Mësuesit: faqe 28.

- Metadoni (kurimi):** faqe 15
- Mjeku roje:** faqe 14
- Mjeku:** faqet nga 13 ke 18
- Modeli 176 bis:** faqa 6
- Modeli 72:** faqe 10
- Ndërrprerja e dënimit:** faqe 26
- Ndërshkimet:** faqe 13
- Ndërshkimet:** faqe 13
- Ndihma familjeve:** faqe 10.
- Neni 17:** faqe 12
- Neni 21:** faqet 10, 11, 21
- Neni 4bis - 41 bis - 416 bis:** faqe 29
- Neni 78:** faqe 12
- Njësia Funksionale e Burgut:** faqet 14, nga 16 ke 18, 28
- Pakot postare:** faqe 6
- Para:** faqet 10, 13
- Paradhënie (lirimi):** faqe 21
- Përgjegjës sektori:** faqe 11
- Përgjegjës sektori:** faqet 11, 12
- Personi i tretë (takime me):** faqe 6
- Policia e burgjeve:** faqet 12, 27
- Praktikat:** faqet 12
- Prifti:** faqe 28
- Programi kurues:** faqet 17, 19, 25, 26
- Proveditori:** faqe 5
- Psikiatri:** faqe 14
- Psikologo:** faqet 4, 11, 12, 16, 18, 28, 29
- Punë jashtë mureve (neni 21):** faqet 10, 11, 21
- Punë:** faqet 8, 27
- Qëndër klinike:** faqe 14
- Raportimet disiplinore:** faqe 13
- Regullorja e brendshme:** faqet 13, 27
- Riintegrimi:** faqet 23, 27, 28
- Riedukimi:** faqet 27, 28
- Rregullorja e Burgjeve:** faqet 6, 27
- Seancat:** faqe 7
- Spektori administrativ e kontabël:** faqe10
- Spektori i sigurisë:** faqet 8, 9
- Spektori i vëzhgimit:** faqet 11, 12
- Spektori pedagogjik:** faqet 11, 12
- Spektori penal jashtë mureve:** faqe 29
- Ser .T.:** faqet 4, 12, 14, nga 16 ke 19, 25, 28
- Shëndetësore (asistenca):** faqet nga 14 ke 20
- Shërbim Observimi dhe Trajtimi:** faqet 11, 12
- Shkolla:** faqet 12, 28
- Shpenzime ligjore:** faqe 10
- Shpenzime:** faqe 10
- Shpërblime:** faqet nga 21 te 27
- SIDA:** faqet 19, 20, 24, 27
- Sieropozitiviteti:** faqet 15, 20, 24, 26, 27
- Simeone-Saraceni (legge):** faqe 27
- Sintesi:** faqet 22, 28, 29
- Sjellja:** faqet 13
- Smuraglia (legge):** faqe 27
- Takime hyrje e parë:** faqet 4, 11
- Takime me familjarët:** faqet 6, 8
- Takime me persona të tjerë:** faqe 6
- Takime me qëllim vëzhgimi:** faqet 4, 11
- Të huajt:** faqet 6, 10, 12, 27
- Tekst Unik mbi imigrimin:** faqe 27
- Telefonatat:** faqe 6
- Thyerjet:** faqe 12
- Thyerjet:** faqet 8, 13
- Trajtimi i burgut:** faqet 7, 8, 11, 12, nga 22 ke 24, 28
- Trajtimi kurues / farmakologjik:** faqet nga 15 ke 20, 26
- Tribunale di Sorveglianza (Gjykata e Mbikqyrjes):** faqet nga 23 ke 26, 28
- Urdhërorja e Burgjeve:** faqet 8, 12, 13, nga 22 ke 24, 27, 29
- Urgjenca:** faqet 9, 14
- Varësit e drogës:** faqet nga 15 ke 17, nga 25 ke 28
- Vërejtje:** faqe 13
- Vëzhgimi:** faqet 4, 11, 12
- Vizita tek Specialisti:** faqet 14, 15
- Vizitë shëndetësore:** faqet 4, 14, 15
- Vullnetarë:** faqet 10, 12, 28
- Zyra e Arkës:** faqe 10
- Zyra e llogarive të rrjedhshme:** Faqe 10.
- Zyra e matrikullit:** faqe 4
- Zyra e mbikqyrjes:** faqe 8

Finito di stampare nel mese di maggio 2006
presso la Tipografia Città Invisibile
via T. Aspetti, 207 - Padova